

VENDIM
Nr. 346, datë 19.6.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 548, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE TË
PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHETËRORE
SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE
DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, “Lista e institucioneve qendrore buxhetore”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, në ndarjen e tretë “Institucione në varësi të Kryeministrit”, emërtesa “Inspektorati Qendror” zëvendësohet me “Inspektorati i Përgjithshëm”.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku